

KONTRATË SHITJE KUOTASH

Sot me date 19.11.2024, ne palet e meposhtme, me vullnetin tone te lire, i nenshtrohem i kesaj kontate si vijon:

SHITESI

Shoqeria DIZI SHPK, regjistruar ne QKB, si person juridik me date 13.02.2015, me NIPT L51413015E, me seli ne Lezhe, Rubik, Vau Shkeze, djathtas rruges Rreshen Rubik, nr. Pasurie 19/11, vell. 1, zona kadastrale 3729, me ortak te vetem **Z.KRISTIAN BOÇI**, atesia Gjok, amesia Marije, i datelindjes 06.03.1977, lindur ne Shengjin, Mirdite, dhe banues ne Tirane, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me nr. personal H70306071S. **DIZI SHPK** ne cilesine e ortakut te vetem te shoqerise **CHRIS SHPK**, me Nipt **L61828201C**, adrese Durres Bubq Fushe Kruje, Bubq, Rruga e Ishmit, Km 1, Nr.387,;

BLERESI

Shoqeria MAK-08 SHPK, regjistruar ne QKR, si person juridik me date 13.01.2008, me NIPT K81313013K, me seli ne Tirane, Rruga Sulejman Delvina, Hyrja nr.1, Ap. 17, Nd. 1834, prane Stadiumit Dinamo, me ortak te vetem dhe njekohesisht perfaqesues ligjor **Z.KRISTIAN BOÇI**, atesia Gjok, amesia Marije, i datelindjes 06.03.1977, lindur ne Shengjin, Mirdite, dhe banues ne Tirane, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me nr, personal H70306071S:

Palët bien dakord për transferimin dhe blerjen e kuotave të shoqërisë **Chriss shpk**, me Nipt L61828201C, adrese Durres Bubq Fushe Kruje, Bubq, Rruga e Ishmit, Km 1, Nr.387

në përputhje me kushtet dhe detajet e mëposhtme:

Objekt i Kontratës

Shitesi shoqeria **DIZI SHPK** me ortak te vetem Z. Kristian Boçi, ne kete kontrate transferon nepermjet shitjes, tek bleresi shoqeria **MAK-08 SHPK**, 100% të kuotave të saj në shoqërinë **CHRIS SHPK**, të cilat përbëhen nga një kuotë e vetme me vlerë nominale 10,000 Lekë (dhjete mije leke). Pala Blerëse, shoqëria **MAK-08 SHPK**, pranon të blejë kuotën e sipërpërmendur dhe të zotërojë të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kjo kuotë pas përfundimit të transferimit.

Çmimi i Shitjes

Shitesi deklaron se çmimi i shitjes se kuotave qe po transferohet nepermjet kesaj kontrate është 10'000 lek (dhjete mije leke) dhe se do te likujdohet plotesisht nga bleresi. Shitesi dhe Bleresi deklarojne se nuk kane asnje pretendim aktual dhe ose te ardhshem ndaj njeri tjetrit ne lidhje me cmimin e shitjes edhe nese ne te ardhmen do te rezultojte ndonje ndryshim financiar apo i cfaredo lloj natyre tjeter qe e ka origjinen perpara dates apo ne daten e nenshkrimit te kesaj kontrate. Pagesa e çmimit do të kryhet nga Pala Blerëse te Pala Shitëse në **vlere te plote brenda 10 diteve nga nenshkrimi i kesaj kontrate cash.**

Heqje dore nga te drejtat

Shitesi deklaroi nen pergjegjesine e tij personale se heq dore nga te gjitha te drejtat qe i takojne ne cilesine e ortakut te vetem te shoqerise **CHRISS SHPK**, dhe te gjitha te drejtat dhe detyrimet i kalojne bleresit te ri me nenshkrimin e kesaj kontrate dhe pas depozitimit te saj ne QKB.

Te ndryshme

Pas realizimit te ketij transferimi nepermjet shitjes me nenshkrimin e kesaj kontrate bleresi shoqeria **MAK-08 SHPK**, behet pronar i ligjshem i shoqerise **CHRISS SHPK**, me vlere te pergjithshme 10,000 Leke (dhjete mijë leke)

Ortaku I vetem I shoqerise behet:

Shoqeria **MAK-08 SHPK**, zoterues i 1 (nje) kuote, dhe pjeses se zoteruar prej saj, me vlere te pergjithshme 10,000 Leke, qe perben 100% te kapitalit te shoqerise.

Forca Madhore

Mospërmbushja e kesaj kontrate nga njera pale nuk do te konsiderohet si shkelje e kesaj kontrate persakohe qe mospermbushja vjen si pasoje e nje ngjarje te konsideruar si force madhore, ne rastin kur provohet se pala e prekur nga kjo ngjarje (a) ka marre te gjitha masat e arsyeshme parandaluese, si dhe te gjitha masat e nevojshme per te permbushur kushtet dhe afatet e kesaj kontrate dhe (b) ka informuar palen tjeter ne menyre te menjehershme per ndodhjen e kesaj ngjarje. Force Madhore do te konsiderohet cdo urdher, rregullore, direktive e qeverise e shpallur ne formen e ligjit apo ne nje forme tjeter, apo cdo lloj sanksioni me natyre kombetare apo nderkombetare, trazire, kryengritje popullore, lufte (e deklaruar apo jo) aksione terroriste apo guerrilase te grupeve apo individeve te vecante, grevave apo shqetesime te tjera te kesaj natyre, zjarre, termete apo cdo lloj shkakut tjeter qe nuk varet nga vullneti i paleve ose nuk vjen si pasoje e neglizhences se tyre qe ata nuk kishin mundesi ta parashikonin. Cdo periudhe kohe brenda se ciles njera prej paleve, bazuar ne kete kontrate do te ndermarre ndonje veprim do te zgjatet ne nje menyre te barabarte me periudhen e kohes ne te cilen pala e kishte te pa mundur te vepronte si pasoje e Forces Madhore. Ne rastet kur ngjarja e Forces Madhore zgjatet me shume se tre muaj rresht, secila pale mund ta zgjidhe ne menyre te njeanshme kete kontrate, pa asnje penalitet.

Kjo kontrate u hartua ne kater ekzemplare me vlere te njejta juridike, ne gjuhen shqipe.

Nënskrimet

SHITESI

DIZI SHPK

Kristian Boçi

BLERESI

MAK-08 SHPK

Kristian Boçi